



Planina / Ditezina Pranoheni / Prilazhi Issued / Delivery	13.07.2022	2 viti god year	
Organ / Pjesa Organ / Unit Org. Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtesa Pitog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAPMSHEK	4079/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.509/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.509/2022 të datës 08.06.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.509/2022 e datës 08.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Policinë e Kosovës, përmes përfaqësuesit me autorizim Shoqëria e Avokatëve më datë 08.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3323/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër përgjigjes me numër reference 07-1-01SAP-P/3418 të datës 25.05.2022 të Drejtorit të Divizionit të Personelit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës administrative dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Policinë e Kosovës. Ndërsa me datë 29.06.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3323/2022 të datës 08.06.2022 të parashtruar në Këshillin Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 14.02.2022; Përgjigjen në kërkesë për pagesë të shujtave, kualifikim shkollor dhe pagës shtesë të datës 25.05.2022; Kërkesën me numër të protokollit 2781 të datës 21.03.2021 për pagesë të shujtave, kualifikim shkollor dhe pages shtesë; Vendimin me Nr. reference 07/1-01A/6160 të datës 31/08/2015; Kontratën e punës për kohor të pacaktuar të ankuesit me Nr. reference 0439; Diplomën me numër 658/13 të datës 02.09.2013 të ankuesit; ID kartela e ankuesit me numër 0493; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Vërtetimin e punësimit me Nr. reference:04/01-08/SRR-NJBNJ176/2022 të datës 02.03.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesme dhe ulet dhe profesionale të datës 18.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesme dhe ulet dhe profesionale të datës 19.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 06.01.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 03.01.2019; Tabelën lidhur me pushimet e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3459 të datës 14.06.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Kontratës së Punës me kohë të pacaktuar me numër reference 0439 të datës 03.09.2011, ankuesi ka qenë i emëruar në pozitën e punës "Asistent Administrativ", Njësie në Malishevë/Drejtoria Rajonale në Prizren. Ndërsa me Vendimin me numër reference 07/1-01A/6160 të datës 31.08.2015 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit, ankuesi është sistemuar në pozitën "Zyrtar i Bazës së të Dhënave", Stacioni Policor në Gjakovë.

Ankuesit me datë 21.03.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqërisë së Avokateve ka parashtruar kërkesë tek Policia e Kosovës, për kompensimin e shujtës ditore, pagës mujore ekuivalente me pagan e rregullt mujore në fund të çdo viti kalendarik dhe shtesave në paga për kualifikim shkollor duke filluar nga data 14.11.2018 deri në pagesën përfundimtare, bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Drejtoria e Personelit Policisë së Kosovës, me përgjigjen me numër 07/1-01SAP-P/3418 të datës 25.05.2022 ka refuzuar kërkesat e ankuesve me arsyetim se *...Kërkesa e Policisë së Kosovës nuk është aprovuar nga autoriteti miratues-Ministrisë së Financave dhe si rrjedhojë e mungesës së mjeteve financiare, kërkesa juaj nuk mund të aprovohet.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: *... 2.Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione..., 3.Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërtime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet*

e pensionit; 4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe beneficionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtaret policorë, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, prej datës 14.11.2018 deri në ditën e parashtrimit të ankesës duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, kurse me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Neni 20 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar kompensimet e nëpunësve civil përtej pagës, duke paraparë se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paafhtësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit; 8 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës; 2.2. shpenzimet e shkaktuara me rastin e shfrytëzimit të automjetit personal për punë zyrtare; 2.3. shpenzimet e shkaktuara gjatë punës në terren; 2.4. shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se stafi civil në Policinë e Kosovës, mund të realizoj vetëm kompensimet përtej pagës të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më datë 09.07.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke i'u

referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.509/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Shoqëria e Avokatëve
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

